



KONTRATË SHITJE KUOTASH

Sot, më 9/12/2024 hartohet dhe nënshkruhet kjo kontratë nga dhe ndërmjet palëve të mëposhtme:

SHITËSI: Z.Florjan Elezi, shtetas shqiptar, i biri i Xanes, i datelindjes 03.01.1992, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, lindur ne Bulqize, dhe banues ne Tirane, i pajisur me leternjoftim (ID) me Nr. 035964347 i cili eshte pjesemarres me 100% te kuotave ne shoqeri

BLERËSI: Z.Olsjon Koxhaj, shtetas shqiptar, i biri i Ramisit, i datelindjes 24.09.1999, lindur ne Kucove dhe banues ne Tirane, i pajisur me leternjoftim (ID) me Nr. 033323168.

Kushte të përgjithshme

- A. Shoqeria "Xsolve shpk" shpk, eshte regjistruar ne QKB si person juridik me Nipt **M41322021V**, me adresë : RRUGA HAJREDIN SHTINO, P30, AP 48, Tiranë, ushtron aktivitetet në fushën e tregëtimit me shumicë e pakicë të pajisjeve elektronike, me Administratori **Florjan Elezi**.
- B. Kapitali themeltar i shoqerise eshte 1000 Leke
- C. Shoqëria zotëron të gjitha licencat, autorizimet dhe lejet përkatëse të lëshuara nga autoritetet kompetente shqiptare për te zhvilluar objektin e saj te veprimtarisë.
- D. Me vendimin e dates 09/12/2024 te Asamblese se Pergjithshme, ortaku i shoqerise Z. Florjan Elezi, zoterues i 100% te kuotave dhe kapitalit te shoqerise ka vendosur t'ia shese te gjithe kuotat e tij Z. Olsjon Koxhaj.
- E. Në përputhje me nenin 73 "Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave" shkronja b, pika 1, te ligjit nr.9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" (i ndryshuar), nenin 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, hartohet kjo kontrate e shitjes së kuotave me kushtet si më poshtë vijon:

Neni 1 Objekti

Shitja dhe Blerja e Kuotave

- 1.1 Me anë të kësaj kontrate, Shitësi i kalon Blerësit titullin e pronësisë, të parënduar me barrë, të **100% te kuotave te kapitalit ne vleren 1000 lek.**

Adresa: Rruga "Hajredin Shtino", P30, Ap 48; E-mail :legal@xsolve.al





- 1.2 Të gjitha të drejtat e lidhura me kuotat në fjalë ndjekin kuotat dhe kalojnë gjithashtu në pronësi të Blerësit.

Kalimi i Pronësisë së Ligjshme mbi Kuotat

- 1.3 Blerësi do të bëhet zotërues me të drejta të plota i kuotave të blera në kapitalin e shoqërisë “XSOLVE” shpk, menjëherë, me nënshkrimin e kësaj kontrate nga të dyja palët.

Neni 2

Çmimi dhe Pagesa

- 2.1 Çmimi i plote i shitjes që Blerësi do t’i paguajë Shitësve për shitjen e Kuotave është i barabartë me 1000 lek.
- 2.2 Çmimi i shitjes do të paguhet nga Blerësi me lekë në dorë.
- 2.3 Në Datën e Nënshkrimit të kësaj kontrate, Blerësi do të jete pronari me të drejta të plota i 100% të kuotave të kapitalit të blere. Kalimi i Kuotave nga Shitësi tek Blerësi dhe çdo dokument shoqërues do të regjistrohen nga administratori ose nga personi i autorizuar i Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 3

Deklarimet dhe Garancitë e Shitësit

Shitësi deklaron edhe garanton se:

3.1 Statusi i Shoqërisë

Shoqëria është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit . Shoqëria është e organizuar në mënyrë të rregullt, ekziston në mënyrë të vlefshme dhe nuk është subjekt i procedurave të falimentimit apo likuidimit sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

3.2 Kuotat e parëduara me Barrë

Kuotat përfaqësojnë 100 % të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, janë të lira nga çdo Barrë dhe nuk ka asnjë marrëveshje, për të krijuar apo rënduar me Barrë asnjë nga Kuotat.

3.3 Pronari i ligjshëm

Adresa: Rruga “Hajredin Shtino”, P30, Ap 48; E-mail :legal@xsolve.al





Shitësit deklarojnë dhe garantojnë se janë pronari të ligjshëm të kuotave që shiten dhe gëzojnë të drejtën të lidhin këtë Kontratë dhe t'i kalojnë Blerësit Kuotat objekt të kësaj Kontrate.

3.4 Përputhshmëria me ligjin

Shoqëria kryen dhe ka kryer aktivitetet tregtar, nga data e themelimit, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm.

Neni 4

TË NDRYSHME

- 4.1 Amendamentet: Kjo Kontratë mund të ndryshohet vetëm me një marrëveshje me shkrim të të dyja palëve.
- 4.2 Pavlefshmëria: Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Kontrate është e pavlefshme, kjo pavlefshmëri nuk prek vlefshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj kontrate. Kushti i pavlefshëm në këtë rast, do të zëvendësohet me një të vlefshëm, i cili do t'i përkojë sa më shumë të jetë e mundur qëllimeve të palëve.
- 4.3 Ligji i zbatuar: Kjo Kontratë bazohet në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr.9901, dt. 14.04.2008 “Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.
- 4.4 Mosmarrëveshjet: Çdo mosmarrëveshje që mund dhe/ose rrjedh nga interpretimi, zbatimi, kryerja, shkelja ose përfundimi i kësaj Kontrate, do të zgjidhet nga Gjykata kompetente.
- 4.5 Gjuha e kontratës: Kjo kontratë është hartuar në 3 kopje origjinale në gjuhën Shqipe, nga një kopje për secilën palë dhe një kopje për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Palët pasi lexuan këtë Kontratë dhe janë dakort me përmbajtjen e saj, me vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë nënshkruajnë si më poshtë.

PALËT

SHITËSI

FLORJAN ELEZI

BLERËSI

OLSJON KOXHAI